

RIATDHESIMI I LHT-VE NGA SIRIA: TË MËSOJMË NGA BALLKANI PERËNDIMOR

CHIARA DEDEKEN DHE KEVIN OSBORNE

SERIA E BALLKANIT PERËNDIMOR

“Pamundësia e riatdhesimit nuk është vetëm një çështje morale dhe e të drejtave të njeriut, por gjithashtu nxit ndjenja urrejtjeje të LHT-ve ndaj vendit të tyre të origjinës.”

DISA FAKTE

- Në nivel kombëtar, garancia për disponueshmërinë e politikave dhe procedurave ligjore është thelbësore për procesin e kthimit.
- Nga konsultimet tona me palët e interesit rezulton se LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre janë keqinformuar për trajtimin në kthim, janë trembur nga rekrutuesit, ose nuk duan të përballen me burgimin.
- Mungesa e kapacitetit dhe e përvojës kanë paraqitur një vështirësi të konsiderueshme për programin e rehabilitimit, riintegrimin dhe risocializimit (RRR).
- Fokusimi në një mjedis mundësues për riintegrimin në një zonë ku besueshmëria e organizatave vendore ka qenë shumë e rëndësishme për të përballuar sfidat rreth stigmatizimit të të kthyerve, familjeve të tyre, dhe të komuniteteve ku janë integruar djem, vajza, gra dhe burra.

Konteksti

Katër shtete në rajonin e Ballkanit Perëndimor (Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi) janë ndër dhjetë shtetet me më shumë luftëtarë të huaj terroristë (LHT) për frymë.¹ Vullneti politik për riatdhesimin e LHT-ve mbetet i palëkundur, të paktën në Ballkanin Perëndimor, pavarësisht vonesave në vitin 2020 për shkak të pandemisë së COVID-19. Në pjesë të tjera të botës, veçanërisht në vendet më të ardhura të larta, vullneti politik për riatdhesimin e LHT-ve është shumë më i pakët. COVID-19 ka vendosur kufizime të mëtejshme ndaj kombeve në përpjekjet e tyre për të riatdhesuar qytetarët që veprojnë në zbatim të ligjit, që është një çështje më pak kontroverdale se familjet e LHT-së.

Së fundmi, Ballkani Perëndimor ka rinisur procesin e riatdhesimeve. Grupe prej nëntëmbëdhjetë, njëmbëdhjetë dhe njëzetë e tre qytetarësh janë kthyer përkatësisht në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, duke treguar mënyrën se si mund të kryhet riatdhesimi.

1 Richard Florida, “The Geography of Foreign ISIS Fighters,” Bloomberg CityLab, August 10, 2016, <https://www.bloomberg.com/news/articles/2016-08-10/the-geography-of-foreign-isis-fighters>.

Dedikimi, udhëheqja dhe përvoja e tyre janë aspekte të vyera për qeveritë anembanë botës. Këto qeveri, me ndihmën e donatorëve perëndimorë, ndërmorën nismën e riadhesimit, kryesisht për shkak të detyrimit moral për të kthyer gra dhe fëmijë që po vuanin.² Janë riadhesuar edhe disa burra, si dhe disa janë kthyer me dëshirë, megjithatë procesi zakonisht përfshin procedura ligjore dhe burgosje.

Bazuar në diskutimet me qeveritarët dhe nëpunësit e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, ashtu si edhe me ekspertët dhe donatorët ndërkombëtarë, kjo notë politike parashikon rekomandime operacionale për avancime lidhur me riadhesimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve bazuar në përvojat e riadhesimeve në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut. Kjo gjë nxit qeveritë anembanë botës të dyfishojnë përpjekjet e tyre të riadhesimit dhe të mbështeten në përvojën e qeverive të Ballkanit për të kthyer LHT-të e tyre tani. Rekomandimet në këtë notë politike janë të aplikueshme për çdo shtet ku mund të inkurajohet vullneti politik për riadhesimin e LHT-ve.

Lidhja me politikat dhe praktikën

Nevoja për riadhesim të shpejtë

Argumentet kundër riadhesimit shpeshherë janë bazuar te rreziqet e sigurisë në lidhje me rehabilitimin dhe riintegrimin e LHT-ve dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Megjithatë, ekspertët kanë theksuar rrezikun shumë herë më të madh të shteteve që nuk arrijnë të riadhesojnë shtetasit e tyre.³ Situata aktuale në Afganistan dhe informacioni që shumë LHT bëhen luftëtarë të huaj në karrierë⁴ e thekson këtë pikë. Kampet janë një „fortesë“ për radikalizimin e dhunës, duke ofruar mundësi për rekrutuesit e konflikteve të ndryshme, si dhe për rekrutimin e luftëtarëve shumë të aftë. Pamundësia e riadhesimit nuk është vetëm një çështje morale dhe e të drejtave të njeriut, por gjithashtu nxit ndjenja urrejtjeje të LHT-ve ndaj vendit të tyre të origjinës.⁵

Pavarësisht thirrjeve të Kombeve të Bashkuara për të riadhesuar shtetasit, shtetet e prekura nuk kanë miratuar një përgjigje të unifikuar.⁶ Në Ballkanin Perëndimor, Kosova ka qenë në pararojë të riadhesimit dhe riintegrimin të LHT-ve. Kosova është shteti i parë i Ballkanit Perëndimor që zbaton kërkesat ligjore dhe institucionale për të adresuar riadhesimin, rehabilitimin dhe riintegrimin, duke rezultuar kështu në riadhesimin e 110 LHT-ve.⁷ Së fundmi, edhe Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë nisur procesin e riadhesimit. Është përllogaritur se 86 kosovarë, 50 shqiptarë, 130 boshnjakë dhe 17 shtetas të Maqedonisë së veriut mbeten ende në kampet siriane.⁸

2 Shikoni, për shembull: Liesbeth Van Der Heide and Audrey Alexander, “Homecoming: Considerations for Rehabilitating and Reintegrating Islamic State-Affiliated Minors” *Combating Terrorism Center at West Point*, June, 2020, <https://ctc.usma.edu/wp-content/uploads/2020/06/Homecoming.pdf>.

3 Shikoni, për shembull: Teuta Avdimetaj and Julie Coleman, “What EU Member States can learn from Kosovo’s experience in repatriating former foreign fighters and their families,” Clingendael Institute, May 2020, https://www.clingendael.org/sites/default/files/2020-06/Policy_Brief_Kosovo_experience_repatriating_former_foreign_fighters_May_2020.pdf.

4 Chelsea Daymon, Jeanine de Roy van Zuijdewijn, and David Malet, *Career Foreign Fighters: Expertise Transmission Across Insurgencies* (Washington, D.C.: RESOLVE Network, 2020), <https://doi.org/10.37805/ogrr2020.1.cff>.

5 Ibid

6 United Nations, “Key principles for the protection, repatriation, prosecution, rehabilitation and reintegration of women and children with links to united nations listed terrorist groups,” April 2019, https://www.un.org/counterterrorism/sites/www.un.org.counterterrorism/files/key_principles-april_2019.pdf.

7 Republic of Kosovo Ministry of Justice, “Minister Tahiri: A second chance for life for children – suspects shall face justice,” April 20, 2019, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,15,2000>.

8 Bazuar në Raportin e përditësuar të GCERF për Vlerësimin e Nevojave Rajonale, në qershor të vitit 2021, të kryer nga Atlantic Initiative, dhe kthimet e tjera të raportuara në korrik të vitit 2021.

Procesi i riatdhesimit: sfidat dhe mundësitë⁹

Me dallime minimale, procesi i riatdhesimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor përbëhet nga katër faza: 1) përgatitja; 2) logjistika; 3) rehabilitimi; 4) riintegrimi; dhe risocializimi.

- **Përgatitja.** Në nivel kombëtar, garancia për disponueshmërinë e politikave dhe procedurave ligjore është thelbësore për procesin e kthimit. Si pikënisje të koordinimit, qeveria autorizon një pikë qendrore kombëtare për Rehabilitim dhe Riintegrim (R&R) dhe miraton strategji kombëtare dhe plane veprimi.¹⁰ Pavarësisht përpjekjeve të mëdha për koordinim, menaxhimi i palëve të shumta të interesit në procesin e riatdhesimit – duke përfshirë institucionet kombëtare dhe vendore, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) – ka qenë i vështirë. Për shembull, riatdhesimet në Kosovë dhe Shqipëri, kanë treguar rëndësinë e vendosjes së Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për fazat e ndryshme për të përcaktuar rolet, përgjegjësitë dhe rezultatet e aktorëve të përfshirë. PSV-të duhet të zhvillohen në koordinim me punonjësit e vijës së parë dhe palët përkatëse të interesit shumë kohë përpara kryerjes së riatdhesimeve; PSV-të duhet të ndahen me palët përkatëse bashkë me ofrimin e trajnimeve.

Procesi i riatdhesimit: Kthimi i luftëtarëve të huaj terroristë dhe i familjeve në BP

Përgatitja

Përgatitja para mbërritjes së të kthyerve përfshin sa më poshtë:

- Vendosja e procedurave juridike dhe ligjore
- Miratimi i strategjive kombëtare për rehabilitim dhe riintegrim, kundër terrorizmit, ose për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe planet e veprimit
- Lokalizimi i shtetasve në kampe
- Negociatat për kthimin me autoritetet e kampit
- Vendosja e pikës qendrore të koordinimit për R&R
- Krijimi i procedurave standarde të veprimit

Logjistika

Logjistika e riatdhesimit përfshin sa më poshtë:

- Zhvendosja e të kthyerve nga kampi Al Hol në Al Roj
- Informimi i të kthyerve për procesin e riatdhesimit
- Riatdhesimi në vendin e origjinës

Rehabilitimi

Mbështetja për LTHK-të dhe familjet në qendrat e pritjes emergjente dhe burgjet përfshin sa më poshtë:

- Analiza mjekësore dhe psikosociale
- Identifikimi i nevojave dhe nisja e menaxhimit të rastit
- Procedura ligjore
- Mbështetje mjekësore dhe psikosociale fillestare në qendrat e pritjes emergjente dhe në burgje

Riintegrimi dhe Risocializimi

Mbështetje në komunitet për LTHR-të, familjet e tyre dhe komunitetet pritëse:

- Mbështetje të drejtpërdrejtë për të kthyerit në komunitetet e tyre të origjinës
- Mbështetje për komunitetet mikpritëse

⁹ Informacioni në këtë seksion bazohet në diskutimet me koordinatorët kombëtarë dhe nëpunësit e sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ashtu si edhe me donatorët vendorë dhe ekspertët ndërkombëtarë.

¹⁰ Gjatë viteve 2014 dhe 2015 Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia e kanë dënuar me ligj pjesëmarrjen në konfliktet e huaja, përmes përditësimit të kodeve penale dhe miratimit të legjisllacionit. Kosova ishte e para që përcaktoi strategjitë dhe planet e veprimit për të udhëzuar riatdhesimin dhe riintegrimin e LHTK-ve, e ndjekur nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Kosova ka miratuar strategji prej vitit 2013, duke nisur me "Strategjinë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë". Më shumë informacion rreth saj dhe strategjive të tjera është i disponueshëm në: <https://kryeministri-ks.net/en/>. Në vitin 2015, Shqipëria miratoi dokumentin "Strategjia Kombëtare e Shqipërisë: Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm". I gjithë informacioni për qasjen e Shqipërisë ndaj parandalimit dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm është i disponueshëm në: <https://cve.gov.al/?lang=en>. Në vitin 2018, Maqedonia e Veriut miratoi dokumentin "Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm" (2018-2022) dhe dokumentin "Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Terrorizmit në Republikën e Maqedonisë" (2018-2022). Në qershor të vitit 2020, Maqedonia e Veriut gjithashtu miratoi Planin Kombëtar për Riintegrimin, Risocializimin dhe Rehabilitimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë dhe të Anëtarëve të Tyre, pas krijimit të grupit kombëtar të punës për riintegrimin. Informacione të mëtejshme disponohen në: [https://vlada.mk/\\$](https://vlada.mk/$).

Përgatitja në qendrat e ndalimit dhe të pritjes emergjente – ose pikat e para të barasvlershme të mbërritjes për të kthyerit – përfshijnë marrjen në konsideratë të ambienteve dhe stafit, ashtu si edhe të procesit të planifikimit pas kthimit të LHT-ve dhe të familjeve. Agjencitë shtetërore konstatuan se procesi i përzgjedhjes së stafit të kualifikuar për qendrat e pritjes paraqet vështirësi. Stafi shpeshherë nuk ka aftësitë e nevojshme të gjuhës arabe dhe të dialekteve lokale për të komunikuar me të kthyerit, në veçanti me fëmijët. Për shkak të mungesës së profesionistëve në pozicionet e shërbimeve civile, stafi në qendrat e pritjes përbëhet shpesh nga profesionistë të rinj të cilët kanë nevojë për shumë trajnim dhe mbështetje. Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF) ofron grante për organizatat vendore për trajnimin dhe mentorimin e nëpunësve civilë për menaxhimin e rasteve, mbështetjen psikosociale, punët sociale, kujdesin e informuar ndaj traumave dhe dhunës, si dhe për çrregullimin e stresit post-traumatik.¹¹

Për të nisur procesin e kthimit, qeveritë duhet të gjejnë vendndodhjen e shtetasve të tyre në kamp dhe t'i identifikojnë ata me mbështetjen e familjeve dhe autoriteteve të kampit. Më pas, nisin negociatat me autoritetet e kampit për të diskutuar cilët shtetas janë gati dhe të gatshëm për riatdhesim. Partnerët ndërkombëtarë si Kryqi i Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe janë të përfshirë në negociatat për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe vullnetin e lirë për riatdhesim. Në shumicën e rasteve, gratë dhe fëmijët kanë prioritet, megjithatë qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë shfaqur dëshirën për riatdhesimin e të gjithë shtetasve.

- **Logjistika.** Faza e logjistikës mbulon vetë riatdhesimin, shpeshherë fillimisht nga kampi Al Hol drejt kampit Al Roj, dhe më pas në vendin e origjinës. Qeveritë mbështeten te partnerët ndërkombëtarë ose dërgojnë stafin e tyre të sigurisë për të lehtësuar riatdhesimin. Të riatdhesuarit zakonisht lajmërohen 24 deri në 48 orë përpara se të kthehen në shtëpi. Lloji i informacionit që marrin LHT-të dhe familjet e tyre në këtë fazë është i ndryshëm. Është e qartë për shumicën e LHT-ve dhe familjeve të tyre, që teksa të kthyerit do të dërgohen në qendrat e pritjes emergjente, burrat kanë më shumë gjasa të ndiqen penalisht dhe të kryejnë dënim me burg. Një nga vështirësitë e kësaj faze ka qenë procesi i bindjes së LHT-ve dhe familjeve të tyre që të kthehen.

Nga konsultimet tona me palët e interesit rezultoi se LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre janë keqinformuar për trajtimin në kthim, janë trembur nga rekrutuesit, ose nuk duan të përballen me burgimin. Kjo është pjesërisht arsyeja pse qeveritë tashmë po investojnë më shumë kohë dhe energji në bisedimet me familjet e LHT-ve në vendin e origjinës, për të forcuar besimin dhe për të ofruar siguri për mënyrën se si do të menaxhohet procesi.

Të kthyerit e tjerë besojnë se kthimi në shtëpi është në kundërshtim me besimet e tyre, pasi ata përsëri mbështesin kauzën fillestare të udhëtimit drejt Sirisë. Një nga mënyrat me të cilat shtetet mund të përballen me këto sfida përfshin fillimisht negociimin me LHT të profilit të lartë, dhe të sigurojnë që procesi është i mirëorganizuar dhe i kujdesshëm ndaj fëmijëve.

- **Rehabilitimi.** Sapo mbërrin, të kthyerit zakonisht mbahen në qendrat e ndalimit për rreth 72 orë për analiza mjekësore dhe psikosociale, për identifikimin e nevojave, dhe në disa raste

¹¹ Informacione të mëtejshme disponohen në faqen e internetit të Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit www.gcerf.org.

për nisjen e procedurave gjyqësore. Më pas, faza e rehabilitimit në qendrat e pritjes nis me programe të personalizuar për çdo rast të veçantë. Subjektet qeveritare përgjegjëse për procesin e rehabilitimit nisin menaxhimin e rasteve për të vlerësuar dhe planifikuar mbështetjen për të cilën të kthyerit do të kenë nevojë në ditët, javët, dhe muajt në vijim. Në këtë fazë paraqiten disa vështirësi.

Mungesa e kapacitetit dhe e përvojës kanë paraqitur një vështirësi të konsiderueshme për programin e rehabilitimit, riintegrimin dhe risocializimit (RRR). Ekipet përgjegjëse për qendrat e pritjes dhe fazën e riintegrimin – zakonisht duke përfshirë psikologë, punonjës socialë, staf mjekësor, mësues, sanitarë dhe kujdestarë – shpeshherë marrin trajnim bazë për ekstremizmin e dhunshëm, që zakonisht ofrohet nga ekspertët ndërkombëtarë ose vendorë (psikologët, akademikët, teologët, etj.). Megjithatë, atyre shpesh u mungon përvoja dhe ekspertiza në menaxhimin e LHT-ve dhe familjeve të kthyer. Kërkesat kohore për punonjësit e vijës së parë kanë qenë tejet të mëdha, duke rezultuar në nevojën për punë të rregullt gjatë fundjavave, si dhe në orë shtesë. Në Kosovë dhe në Shqipëri, mbështetja nga OShC-të ka qenë thelbësore për përballimin e këtyre sfidave.

Nevojat e të kthyerve pas kthimit, duke përfshirë ato fizike edhe psikologjike, kanë qenë të vështira për t'u parashikuar duke pasur shumë pak informacion mbi përvojën e tyre gjatë qëndrimit në kampe. Palët e përfshira të interesit në programet RRR shpeshherë nuk kanë qenë të mirëpërgatitura për nevojat dhe sfidat e fazave të ardhshme.

- **Riintegrimi dhe risocializimi.** Faza përfundimtare është riintegrimi dhe risocializimi në shoqëri. Ashtu si me hapat e mëparshëm, konsultimi me familjen e të kthyerve është thelbësor për të vlerësuar sistemin ekzistues të mbështetjes së riintegrimin. Në shumë raste, të kthyerit dhe komunitetet pritëse përfitojnë nga mbështetja e OShC-ve të besueshme dhe me akses në komunitetet lokale. Për shembull, OShC-të e themeluara nga GCERF zhvillojnë kapacitetin e institucioneve të qeverisë vendore dhe të punonjësve të vijës së parë, ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për të kthyerit dhe familjet e tyre, si dhe punojnë për të promovuar një mjedis mundësues për riintegrimin në komunitetet e origjinës. Mbështetja e drejtpërdrejtë e të kthyerve dhe e anëtarëve të komunitetit të tyre mund të përfshijë, por nuk kufizohet në, mbështetje psikosociale, këshillim fetar, trajnim profesional, mundësi punësimi, mbështetje arsimore dhe aktivitete argëtuese për fëmijët. Fokusimi në një mjedis mundësues për riintegrimin në një zonë ku besueshmëria e organizatave vendore ka qenë shumë e rëndësishme për të përballuar sfidat rreth stigmatizimit të të kthyerve, familjeve të tyre, dhe të komuniteteve ku janë integruar djem, vajza, gra dhe burra.¹²

Rekomandime

Si përfundim, kjo notë politike nxit palët vendore dhe ndërkombëtare të interesit të zbatojnë këto rekomandime:

Për qeveritë kombëtare:

- Riatdhesimi i LHT-ve, familjeve të tyre dhe fëmijëve nga kampet në Sirinë verilindore. Shembulli i Kosovës tregon se riadhesimi nuk ka sjellë një rritje të ekstremizmit të dhunshëm dhe se të kthyerit mund të riintegrohen me sukses. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë treguar

¹² Për më shumë informacion, shikoni: www.gcerf.org.

përvojën e tyre me kthimet dhe me procesin e RRR-së dhe janë të gatshëm ta ndajnë me të tjerët.

- Rëndësia e përgatitjes së një mjedisi mundësues është thelbësore. Investoni në përgatitjen e komuniteteve pritëse, në punonjësit e vijës së parë dhe në proceset përmes planeve të mirëzhvilluara të veprimit, në PSV, dhe trajnimet.
- Centralizoni bashkërenditjen e palëve të ndryshme të interesit për të shmangur mbivendosjen dhe nxisni programet e qëndrueshme.
- Identifikoni mundësitë për të punuar me OShC-të vendore, që kanë burimet, ekspertizën, njohurinë dhe akses në komunitet lokale. Përfshini OShC-të në procesin e RRR-së për të kthyerit. Përvoja jonë në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut tregon se Memorandumet e Mirëkuptimit mes qeverive dhe OShC-ve mund të përmirësojnë bashkëpunimin në të gjitha fazat e programeve të RRR-së.

Për donatorët dhe politikëbërësit

- Kalimi i financimeve nga siguria e lartë në RRR dhe në parandalim.
- Forcimi i kapacitetit të fondeve të institucioneve kombëtare dhe vendore përmes OShC-ve vendore.
- Koordinimi me institucionet qeveritare kombëtare dhe vendore për të vlerësuar nevojat e LHT-ve dhe familjeve të tyre.
- Ofroni financim afat gjatë: më shumë se 60 muaj.
- Ofroni mbështetje dhe mundësi të barabarta për LHT-të e kthyer dhe komunitetet pritëse për të parandaluar stigmatizimin.

Sugjerime për lexim të mëtejshëm

Gyte, Joseph, Sara Zeiger, and Thomson Hunter. *Blueprint of a rehabilitation and reintegration centre – guiding principles for rehabilitating and reintegrating returning foreign terrorist fighters and their family members*. Abu Dhabi, Hedayah, 2020. https://www.hedayahcenter.org/resources/reports_and_publications/rftfrehabblueprint/.

Hedayah. *Guidelines and good practices: Developing National P/CVE Strategies and Action Plans*. Abu Dhabi, Hedayah, 2016. <https://www.hedayahcenter.org/resources/good-practices/guidelines-good-practices-developing-national-p-cve-strategies-action-plans/>.

Hedayah. *Malta Principles for Reintegrating Returning Foreign Terrorist Fighters (FTFs)*. Abu Dhabi, Hedayah, 2019. <https://www.hedayahcenter.org/wp-content/uploads/2019/07/File-26102016223519.pdf>.

Meines, Marije, Merel Molenkamp, Omar Ramadan, and Magnus Ranstorp. *RAN Manual: Responses to returnees: Foreign terrorist fighters and their families*. Radicalisation Awareness Network, 2017. https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files_en?file=2020-09/ran_br_a4_m10_en.pdf.

Scherrer, Amandine, Francesco Ragazzi, and Josh Walmsley. *The return of foreign fighters to EU soil – Ex-post evaluation*. Bruksel: European Parliamentary Research service, 2018. [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/621811/EPRS_STU\(2018\)621811_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/621811/EPRS_STU(2018)621811_EN.pdf).

Walkenhorst, Dennis, Till Baaken, Maximilian Ruf, Michèle Leaman, Julia Handle, and Judy Korn. *Rehabilitation Manual: Rehabilitation of radicalised and terrorist offenders for first line practitioners*. Radicalisation Awareness Network, 2020. https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-06/ran_rehab_manual_en.pdf

Bibliografia

Atlantic Initiative. "Updated Regional Needs Assessment". *Global Community Engagement and Resilience Fund*, June, 2021.

Avdimetaj, Teuta, and Julie Coleman. "What EU Member States can learn from Kosovo's experience in repatriating former foreign fighters and their families." *Clingendael Institute*, May, 2020. https://www.clingendael.org/sites/default/files/2020-06/Policy_Brief_Kosovo_experience_repatriating_former_foreign_fighters_May_2020.pdf.

Daymon, Chelsea, Jeanine de Roy van Zuijdewijn, and David Malet. *Career Foreign Fighters: Expertise Transmission Across Insurgencies*. Washington, D.C.: RESOLVE Network, 2020. <https://doi.org/10.37805/ogrr2020.1.cff>.

Florida, Richard. "The Geography of Foreign ISIS Fighters," *Bloomberg CityLab*, August 10, 2016. <https://www.bloomberg.com/news/articles/2016-08-10/the-geography-of-foreign-isis-fighters>.

Republic of Kosovo Ministry of Justice. "Minister Tahiri: A second chance for life for children – suspects shall face justice." April 20, 2019. <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,15,2000>.

United Nations. "Key principles for the protection, repatriation, prosecution, rehabilitation and reintegration of women and children with links to united nations listed terrorist groups." April, 2019. https://www.un.org/counterterrorism/sites/www.un.org/counterterrorism/files/key_principles-april_2019.pdf.

van der Heide, Liesbeth, and Audrey Alexander. "Homegoing: Considerations for rehabilitating and reintegrating Islamic state-affiliated minors." *Combating Terrorism Centre*, June, 2020. <https://ctc.usma.edu/wp-content/uploads/2020/06/Homecoming.pdf>.

Rreth Notës

Autorët: Chiara Dedeken dhe Kevin Osborne

Chiara Dedeken është Partnere e Menaxhimit të Portofolit pranë Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF). Chiara mbështet programet e bazuara në komunitet të GCERF-së për rehabilitimin, riintegrimin dhe risocializimin e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe të familjeve të tyre në Ballkanin Perëndimor.

Kevin Osborne është Drejtori Kombëtar dhe pika e kontaktit për Kthimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë të Kthyer, pranë Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF). Kevin mbikëqyr portofolin e GCERF-së në Ballkanin Perëndimor dhe është përgjegjës në nivel global për punën e GCERF-së me LHT-të.

Chiara dhe Kevin banojnë në Gjenevë, Zvicër dhe punojnë për Sekretariatit e GCERF-së, dhe udhëtojnë shpeshherë drejt Ballkanit Perëndimor.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve. Ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e „RESOLVE Network“, „U.S. Institute of Peace“ (Instituti i Paqes i SHBA-ve) ose të ndonjë organi qeveritar të SHBA-ve.

RESOLVE NETWORK

hulumtim më i thelluar • praktikë e bazuar në informacion • politika të përmirësuara kundër ekstremizmit të dhunshëm •

www.resolvenet.org



„RESOLVE“ e ka selinë në Institutin e Paqes të SHBA-ve dhe mbështetet në trashëgiminë dhjetëra vjeçare të angazhimit të thellë të Institutit në komunitetet e përfshira nga konflikti.

